

VENDIM
Nr. 595, datë 1.7.2015

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL DHE VËNIEN NË DISPOZICION TË PASURIVE PËR NDËRTIMIN E SHTËPIVE DHE INFRASTRUKTURËS SË NEVOJSHME PËR SISTEMIMIN E PERSONAVE TË PREKUR NGA NDËRTIMI I HEC-it TË BANJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10083, datë 23.2.2009, “Për miratimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga tokë bujqësore në tokë truall të sipërfaqes prej 1 850 (një mijë e tetëqind e pesëdhjetë) m², sipas lidhjes 1 dhe hartave përkatëse, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Sipërfaqja e tokës së përcaktuar në lidhjet 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi, vendoset në dispozicion të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për ndërtimin e shtëpive e të infrastrukturës përkatëse (rrugë), në përputhje me dokumentet e planifikimit të territorit. Ndërtimi i shtëpive dhe i infrastrukturës përkatëse është në funksion të sistemit të personave të prekur nga HEC-i i Banjës, sipas kushteve të programit social të marrë përsipër nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., në kuadër të zbatimit të projektit hidroenergjetik Devoll. Kostot për ndërtimin e shtëpive e të infrastrukturës përkatëse (rrugë) përballohen nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., në përputhje me kushtet e marrëveshjeve individuale, të nënshkuara me familjet që janë pjesë e kësaj skeme.

3. Lista e familjeve, që do të përfitojnë shtëpi të ndërtuara sipas programit social që do të zbatohet nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., dhe të dhënat për pasurinë ku do të ndërtohen këto shtëpi përcaktohen në lidhjen 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Elbasan të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit nga tokë bujqësore në tokë urbane (truall) për sipërfaqen prej 1 850 (një mijë e tetëqind e pesëdhjetë) m², sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Çdo vendim i Këshillit të Ministrave apo akt tjetër administrativ, që bie në kundërshtim plotësisht ose pjesërisht me këtë vendim, të ndryshohet ose të shfuqizohet.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të bëjnë ndryshimin e llojit të pasurive nga tokë bujqësore në tokë truall në certifikatat e pasurive, sipas të dhënave për pasurinë, të përcaktuara në lidhjet 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Kostot në lidhje me regjistrimin e pasurisë dhe objekteve që do të ndërtohen, përballohen nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, për pronat në lidhjet 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi, të bëjnë shënimin përkatës në kartelën e këtyre pronave, ku të shënojnë “Vënie në dispozicion për ndërtimin e shtëpive/banesave sociale dhe infrastrukturës përkatëse në kuadër të programeve sociale të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në funksion të masave zbutëse minimizuese sociale, në kuadër të ndërtimit të projektit hidroenergjetik Devoll. Çdo kosto në lidhje me shënimin përkatës në kartelë do të përballohet nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a.

8. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, ku do të kryhen ndërtimet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1 – Tokë Arë (kategoria V-X):

Komuna	Fshati	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe (m²)	Kategoria e tokës bujqësore	Koment ZVRPP Gramsh	Truall i kërkuar (m²)	Tokë e kërkuar për infrastrukturë publike (rrugë)
Pishaj	Cingar i Poshtem	3262	48/68	Shteti	Are	1500	8		1050	300
Sult	Dushk	1580	226/6	Shteti	Are	106160	5		350	150
Total									1400	450

Lidhja 2 – Tokë në kategori tjetër:

Komuna	Fshati	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe (m²)	Kategoria e tokës bujqësore	Koment ZVRPP Gramsh	Truall i kërkuar (m²)	Toke e kërkuar për infrastrukturë publike (rrugë)
Kodovjat	Kodovjat	2188	156/10	Shteti	Shkëmbore	11776	E pakategorizuar		350	100
Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shteti	Eroduar	7200	E pakategorizuar		2450	500
Pishaj	Drize	1556	142/1	Shteti	Truall	472	E pakategorizuar	21.03.2000 – Kufizim – Pasuria nr. 142/1	472	
Pishaj	Drize	1556	142/4	Shteti	Truall	5440	E pakategorizuar		228	350
Gramsh	Gramsh	1842	7/42	Shteti	Truall	6731.1	E pakategorizuar	Me VKM nr. 431, datë 11.7.2007	700	40
Total									4200	1050

Lidhja nr. 3 – Të dhënat për pasuritë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Komuna/ Bashkia	Fshati	Zona Kadastrale	Nr. Paturisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Persona sipas certifikatës familjare	Persona total sipas inventarit (te deklaruar nga vete familjaret)	Persona qe jetojnë ne shtëpi	Persona qe jetojnë përkohësisht (student, emigrante, kujdestare etj.)
1	Andon	Scami	Dhëmbi	Kodovjat	Kodovjat	2188	156/10	Shtet	Shkëmbore	4	4	4	0
2	Shefki	Mersin	Çarçiu	Pishaj	Drize	1556	142/1; 142/4	Shtet	Truall	4	4	0	4
3	Hyqmet	Tefik	Tafa	Sult	Dushk	1580	222/6	Shtet	Are	4	5	1	4
4	Ismail	Shaip	Jança	Pishaj	Cingar i Poshtem	3262	48/68	Shtet	Are	3	9	9	0
5	Selim	Arif	Buzdra	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	4	4	2	2
6	Qamil	Mustafa	Tafa	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	6	6	4	2
7	Flamur	Sadik	Tërvoli	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	3	3	3	0
8	Xhafer	Hamit	Kullolli	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	4	2	2	0
9	Ramadan	Liko	Baloshi	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	2	7	5	2
10	Xhezare	Shaban	Tafa	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	5	6	0	6
11	Samit	Ali	Kryemadhi	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	4	5	0	5
12	Hekuran	Arif	Llapushi	Gramsh	Gramsh	1842	7/42	Shtet	Truall	3	6	0	6
13	Ismail	Sadik	Qyra	Gramsh	Gramsh	1842	7/42	Shtet	Truall	10	7	7	0
14	Kudret	Hekuran	Çarçiu	Pishaj	Drize	1556	142/1; 142/4	Shtet	Truall	5	5	5	0
15	Garip	Hajdar	Zogu	Pishaj	Cingar i Poshtem	3262	48/68	Shtet	Are	6	9	3	6